

# STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “LEKA 2023”SH.P.K

Ne baze te **Ligjit Nr.9723** , date 03.05.2007”Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit” dhe **Ligjit Nr.9901**, date 14.04.2008 ....., per “Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare “, me vullnetin tim te lire shpreh nenshkrimin e Stautit.

Une kerkuesi :

“ **LEKA 2023”SH.P.K** me seli qendrore ne Librazhd Lagjja nr 1, Sheshi Gjorg Golemi objekt privat me zone kadastrale 2446, me numer pasurie 1/168. , me ortak te vetem Z. Arjanit Leka i datelindjes **12.10.1971** mbajtes i kartes se indentitetit me nr. **H11012042W**

**Hartoj , Statutin e Shoqerise si me poshte vijon :**

## FORMIMI

Neni 1

Formohet Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar me emertimin “**Leka 2023 SH.P.K** nga ortaku i vetem Z. Arjanit Leka i datelindjes 12-10-1971 mbajtes i kartes se indentitetit me nr. **H11012042W**

## VENDQENDRIMI

Neni 2

Selia e Shoqerise do te jete ne Librazhd Lagjja nr 1, Sheshi Gjorg Golemi objekt privat me zone kadastrale 2446, me numer pasurie 1/168.

## KOHEZGJATJA

Neni 3

Kohezgjatja e aktivitetit te Shoqerise do te jete per nje afat te pacaktuar dhe mund te shperbehet ne cdo kohe. Shoqeria mund te ndryshoje emrin , seline,si edhe objektin e saje sipas vendimit te ortakut te vetem te shoqerise.

#### Neni 4

Veprimtaria e shoqerise do te zhvillohet ne perputhje te plote me dispozitat e ketije statuti, te Aktit te Themelimit dhe mbeshtetur ne legjislacionin shqiptar ne fuqi , akteve ligjore e nenligjore qe rregullojne aktivitetin dhe funksionimin e shoqerise tregtare.

#### Neni 5

Shoqeria vepron ne regjimin e prones dhe merr vet persiper te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe ka.

Ajo pergjigjet vet per detyrimet e saj kontraktore e jashtkontraktore Brenda kapitalit qe ka .

Ortaku i vetem i shoqerise bart rrezikun e veprimtarise se shoqerise Brenda kapitalit te sajje.

### **OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

#### Neni 6

Aktivitetin e sajje shoqerija do ta zhvilloje ne fushen e:

Kembim valutore, veprimtari e agjentit per transferte parash ne emer dhe per llogari te nje subjekti financiare jobanke, te gjitha sherbimet e pagesave dhe te transferimit te parave ne emer dhe per llogari te nje subjekti financiare jobanke, Ak-Invest, siguracione automjetesh.

Megjithate Shoqeria ka te drejte te marre persiper edhe ativitete te tjera , te shtoje aktivitetin e sajje , te hape filjale e dege ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë .

### **KAPITALI I SHOQERISE**

#### Neni 7

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte **2.500.000 leke** i cili perben 1(Nje) kuote i formuar teresisht nga themeluesi i saj , Z. Arjanit Leka i cili eshte mbajtes i 100% te aksioneve , e perbere nga 1(Nje) kuote e nenshkruar , me vlere nominale 2500000



#### Neni 8

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te paksohet sipas vendimit qe do te marre ortakun I vetem .Aktiviteti ne kete Shoqeri nuk pengon ortakun e vetem te kete te drejta pronesie jashte Shqiperise ,qofte si person fizik apo juridik . Shoqerija nuk pergjigjet per detyrimet e ortakut te vetem te shoqerise jashte shoqerise.

#### Neni 9

Shoqeria eshte pergjegjese vetem per kapitalin e mjetet qe disponon dhe asgje me teper.

### **BILANCI DHE TE ARDHURAT**

#### Neni 10

Shoqeria percakton fondet e saje , fondin reserve, ate te akumulimit si edhe fonde te tjera te domosdoshme per zhvillimin e aktivitetit te saje.Fondi themeltar i Shoqerise perbehet nga mjetet e investuara nga ortakun i vetem i shoqerise .Shoqeria e shfrytezon kete fond per ecurine e Shoqerise si edhe per te mbuluar rreziqet pa shfrytezuar fondin rezerve.

Perberja dhe shumet e cdo fondi caktohen dhe kontrollohen nga ortakun i vetem i Shoqerise.

#### Neni 11

Kur Shoqeria pushon aktivitetin e saje, pasi shlyen te gjitha detyrimet qe ka , pjesa e mbetur e kapitalit i perket tersisht ortakut te vetem te shoqerise.

#### Neni 12

Veprimet ekonomike te Shoqerise mbyllen me 31 Dhjetor te cdo fund viti . Ne fund te periudhes ushtrimore , administratori i Shoqerise nxjerr bilancin me rezultatin **HUMBJE- FITIME.**

Llogarite vjetore , inventari, raportet e operacionet e veprimtarise financiare te vitit , te hartuara nga administratori dhe eksperti kontabel i autorizuar miratohet nga ortakun i vetem i shoqerise .

Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarine vjetore te shoqerise behet Brenda gjashte muajve nga data e mbylljes se vitit financiare.



Bilanci vjetor duhet te paraqitet Brenda muajit Mars te vitit ne vazhdim ne organet perkatese sipas ligjit..Ne bilancin vjetor ,administratori parashikon edhe fondet e ndryshme qe i nevojiten Shoqerise gjate kryerjes se aktivitetit te saje.

## DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

### Neni 14

Oraganet drejtuese te shoqerise jane:

- **Ortaku I vetem I shoqerise**
- **Administratori**
- **Komisioni I eksperteve kontabel.**

Detyrat e komisionit te eksperteve kontabel , caktohen ne perputhje me ligjin per kontabilitetin

### Neni 15

Administrator i Shoqerise eshte **Z. Arjanit Leka** njeheresh edhe ortak i vetem i shoqerise, per nje periudhe prej 5(Pese\_) vjetesh me te drejte rizgjedhje.

### Neni 16

Vendimet e ortakut te vetem te shoqerise jane oragani vendimor i shoqerise .

Nepermjet vendimeve te marra nga ortakut i vetem , Shoqeria realizon te gjithë aktivitetin e saje , ajo percakton drejtimet kryesore , vendos per bilancin vjetor, per fuqine puntore, pagat e tyre sipas ligjit “Mbi shoqerite Tregtare”

### Neni 17

Shoqeria mund te shperndahet me likujdimin e saje Me kete rast emertimi I saje do te pasurohet nga shenimi “**SHOQERI NE LIKUJDIM E SIPER**”.

### Neni 18

Shperndarja e shoqerise mund te vije ne cdo kohe per arsytet qe parashikohen me ligj.

Per kete Administratori kerkon prane Organit kompetent , likujdimin e Shoqerise,Caktohet nje ose disa likujdatore , te cilet bejne kujdes qe Shoqeria me pare te likujdoje detyrimet qe ajo ka me persona te trete fizik ose juridik dhe pjesa e mbetur e kapitalit , I ngelet Shoqerise.

Neni 19

Administratori ka te drejte te emroje ekonomiste e avokate si dhe tu jape te drejta personave te trete qe te veprojne ne emer e per llogari te tije.

Neni 20

Shoqeria deklarohet e krijuar me regjistrimin e sajë ne Zyren e Rregjistrimit Tregtare ne Qendren Kombetare Te Rregjistrimit.Me regjistrimin e sajë ne Organin Kopetent, Shoqeria fiton zotesine e sajë juridike, ndersa nga aktiviteti fillon pas regjistrimit ne Zyren e Taksa-Tatimeve perkatese.

DISPOZITA TE VECANTA

Neni 21

Shoqeria ka vulen e sajë, permbajtja e seciles eshte e njejte me emertimin e sajë.

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 22

Per sa nuk eshte trajtuar ne kete statut , I referohet plotsimeve qe behen nga ortaku I vetem i shoqerise nepermjet vendimeve qe merren prej tijë si dhe ne referim te ligjit Nr.9901 date 14.04.2008” per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”

Neni 23

Ky statut u redaktua ne disa kopje , nje nga te cilat depozitohet ne Qendren Kombetare te Regjistrimit nje kopje ne Zyren e Tatim Taksave , nje kopje depozitohet prane bankave perkatese ne te cilat shoqerija ka llogari bankare dhe kopje tjeter origjinale mbahet ne dokumentacionin e Shoqerise “**LEKA 2023** “**SH.P.K .**

Librazhd me 09.01.2023

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE**

**Arjanit Leka**

